



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 386/4 Prot.

Tiranë, më 22.06.2016

V E N D I M
Nr. 71, datë 22.06.2016

*“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit,
filluar me Urdhrin nr. 386/1 prot., datë 25.05.2016”*

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe nenet 14 e 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, që lejohen të veprojnë prej nenit 185, i ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH” si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në përfundim të procedurës së verifikimit,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit nr. 386/1 prot., datë 25.05.2016, pas marrjes në shqyrtim të një informacioni të regjistruar me nr. 386 prot., datë 11.05.2016, u krye hetimi administrativ për verifikimin e ligjshmërisë të veprimit administrativ të kryer nga Kryetari i Bashkisë Selenicë, nëpërmjet aktit nr. 705, datë 21.04.2016, për fillimin e procedurave për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të punonjëses ******, me detyrë “*Ekonomiste*”, pranë Njesisë Administrative Kotë.

Nga aktet e administruara ka rezultuar se, *nëpunësja *******, ka filluar marrëdhënien e punës me aktin e emërimit të Kryetarit të ish-Komunës Kotë, në datën 08.05.2002 (*ky akt nuk përmban numër protokolli*), në detyrën “*Inspektore në degën e Financës*”, marrëdhënie të cilën e ka vazhduar pa shkëputje deri në datën 16.05.2016, kur i është ndërprerë marrëdhënia e punës, duke aplikuar rregullat e parashikuara në Kodin e Punës.

Megjithëse fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, e ka gjetur këtë punonjëse të punësuar në një pozicion që përfshihet në shërbimin civil, për një periudhë mëse 13 vjet, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të ish-Komunës Kotë (*e cila paraqitej me cilësinë e njësisë përgjegjëse para konstituimit të bashkisë*), pa të drejtë nuk është shprehur në lidhje me statusin e punësimit të saj, sipas parashikimit të nenit 67 pika 3, të ligjit në fjalë dhe Vendimit nr. 116, 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”*.

Ky mosveprim i administratës së ish-Komunës Kotë, është pasuar edhe nga mosveprimi i njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Selenicë, e cila sipas germës “c”, Kreu IV, të Vendimit nr. 510, datë 10.06.2015, të Këshillit të Ministrave, pas konstituimit të bashkisë, ka marrë funksionet e njësisë përgjegjëse për gjithë personelin e Bashkisë Selenicë, dhe brenda afateve të përcaktuara në Kreun IV, të Vendimit nr. 116 datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”* (ndryshuar me VKM nr. 532 dt. 06.08.2014) kishte detyrimin ta përmbyllte procesin e deklarimit të statusit të punësimit për të gjithë punonjësit.

Por, pavarësisht mosveprimit të kundërligjshëm të njësisë përgjegjëse, nëpunësja ***** , në vështrim të dispozitave të sipërpërmendura, e ka përfituar statusin e nëpunësit civil dhe duhet të trajtohet në të gjitha drejtimet, si e tillë, si në kuptim të përfitimit të mundësive dhe të drejtave që përmban statusi i nëpunësit civil, ashtu dhe në drejtim të respektimit të procedurave të ndryshme që parashikon legjislacioni i shërbimit civil, për mënyrën e zhvillimit të karrierës, lëvizjeve të brendshme, vlerësimit të punës, kryerjes së procedimit disiplinor, etj.

Në rastin që shqyrtohet, në thelb jemi para një procedimi disiplinor, për të cilin në veçanti, në legjislacionin e shërbimit civil, parashikohen rregulla rreptësisht të përcaktuara. Konkretisht, një proces disiplinor fillon me momentin e vlerësimit të rëndësisë së shkeljes, në të lehtë, të rëndë dhe shumë të rëndë, sipas përcaktimit të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, pasi kjo lidhet ngushtë me kompetencën e organit që ka të drejtë të shqyrtojë këtë shkelje dhe të aplikojë masat disiplinore të përcaktuara në nenin 58, të ligjit në fjalë, e cila determinon dhe mënyrën e procedimit të secilit organ disiplinor, siç përcaktohet në nenin 59 të tij.

Nga materialet e administruara, rezulton se shkak për këtë procedim administrativ janë bërë konkluzionet e Raportit Përfundimtar të Auditit të Ligjshmërisë dhe Rregullshmërisë Financiare, të një ekipi të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të përpiluar pas auditimit të Njesisë Administrative Kotë (*ish-Komuna Kotë*), sipas të cilit, është rekomanduar nisja e procedurave administrative disiplinore për disa punonjës, në punën e të cilëve janë konstatuar parregullsi, ndërmjet të cilëve përfshihet edhe punonjësja në fjalë (*pa klasifikuar natyrën e shkeljes dhe pa përcaktuar llojin e masës disiplinore që do të aplikohet - shiko aktin nr. 366/8, prot., datë 31.07.2015, të KLSH*).

Nisur nga ky rekomandim, Kryetari i Bashkisë Selenicë me shkresën nr. 705, datë 21.04.2016, ka njoftuar nëpunësen ***** për fillimin e procedurës të zgjidhjes së kontratës së punës, duke e trajtuar marrëdhënien konkrete të punës si marrëdhënie kontraktore dhe jo si marrëdhënie në

shërbimin civil. Në vijim, ashtu siç ishte bërë planifikimi, është realizuar një takim për njohjen me shkaqet e cenimit të marrëdhënies së punës, në të cilin është mbajtur dhe procesverbali me nr. 705/1 prot., datë 03.05.2016. Pas kësaj, Kryetari i Bashkisë Selenicë, me aktin nr. 906 prot., datë 16.05.2016, *“Për ndërprerjen e menjëhershme dhe të justifikuar të marrëdhënieve të punës”*, ka vendosur ndërprerjen e marrëdhënies të punës për nëpunësen *****, me motivacionin *“Shkelje e detyrimeve kontraktuale, me faj të rëndë”*.

Veprimet e mësipërme të Kryetarit të Bashkisë Selenicë, vijnë në kundërshtim me ligjin, pasi padrejtësisht, mosmarrëveshjen e lindur e ka trajtuar në bazë të dispozitave të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995, *“Kodi i Punës i RSH”*. Në bazë të pikës 2, të nenit 1, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, *“Marrëdhënia e shërbimit civil është marrëdhënie juridike e natyrës administrative”* (citim) dhe nuk mund të konsiderohet si marrëdhënie kontraktore. Si e tillë, marrëdhënia në fjalë, detyrimisht, duhet të trajtohet sipas dispozitave procedurale të legjislationit të shërbimit civil.

Parë në këtë vështrim, eprori direkt, pasi ka marrë dijeni për rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke u bazuar në rregullat e përcaktuara në Kreun X *“Disiplina në shërbimin civil”*, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe në Vendimin nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”*, ishte i detyruar të bënte vlerësimin paraprak të rastit dhe nëse çmonte që shkelja disiplinore e konstatuar ishte e natyrës së lehtë, në bazë të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ta fillonte dhe ta përfundonte vetë këtë procedurë dhe në rastin që shkelja/shkeljet do të vlerësoheshin prej tij, si shkelje të rënda/shumë të rënda, në bazë të pikës 2, të dispozitës së mësipërme, duhej t’ja kalonte çështjen për shqyrtim Komisionit të Disiplinës.

Në këto kushte, nxjerrja e një aktit administrativ në zbatim të një reference të gabuar ligjore (*Kodi i Punës*), pa respektuar procedurat për zhvillimin e një ecurie disiplinore të parashikuara nga ligji nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, përbën akt të nxjerrë në kapërcim të kompetencës dhe në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji, gjë e cila në bazë të nenit 115, pika “a”, dhe 116, shkronjat “b” dhe “c”, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 *“Kodi i Procedurave Administrative”*, passjell pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nr. 906 prot., datë 16.05.2016, *“Për ndërprerjen e menjëhershme dhe të justifikuar të marrëdhënies të punës”*, të nëpunëses *****.

Sqarojmë se në këtë rast i referohemi dispozitave të mësipërme të procedurës administrative, pasi pavarësisht se tashmë ka hyrë në fuqi ligji nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, në nenin 185 të tij, parashikohet që, për procedurat administrative, që kanë filluar para hyrjes në fuqi të këtij Kodi, si në rastin konkret, zbatohen dispozitat e ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*.

Ky akt absolutisht i pavlefshëm, në bazë të nenit 117 pika 1, të ligjit të sipër cituar, nuk mund të prodhojë pasoja ligjore pavarësisht nga fakti nëse është deklaruar apo jo si e tillë, prandaj marrëdhënia e punës së nëpunëses *****, duhet të konsiderohet e pandërprerë dhe ajo duhet të kthehet në pozicionin e mëparshëm të punës.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; e nenin 35, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. T’i kërkoj njësisë përgjegjëse, të drejtojë procesin e rregullimit të ligjshmërisë, për revokimin e aktit administrativ nr. 906 prot., datë 16.05.2016, “Për ndërprerjen e menjëhershme dhe të justifikuar të marrëdhënieve të punës të nëpunëses *****”, të Kryetarit të Bashkisë Selenicë, si akt administrativ absolutisht i pavlefshëm dhe kthimin e nëpunëses ***** në vendin e saj të punës.
2. Njësia përgjegjëse, të përfundojë procedurën e deklaramit të statusit të punësimit në shërbim civil, për nëpunësen *****, si dhe për raste të tjera të njëvleftshme të punonjësve të tjerë në këtë institucion, sipas kërkesave të përcaktuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe germës “c”, Kreu IV, të Vendimit nr. 510, datë 10.06.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.
3. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Selenicë, të zbatojë vendimin brenda **10 ditëve** nga data e marrjes dijeni, dhe pas këtij afati të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me aktet përkatëse, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Të njoftohet për këtë vendim, Bashkia Selenicë dhe nëpunësia *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA